



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" GJILAN
PUBLIC UNIVERSITY "KADRI ZEKA" GJILAN

Zija Shemsiu pn., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës
www.uni-gjilan.net tel: 0280390

Ref. Nr.

Duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 paragrafi 3, pika 3.5, dhe nenit 13 paragrafi 2 pika 2.3 të Ligjit për arsimin e lartë të Republikës së Kosovës, si dhe dispozitat e nenit 48 paragrafi 1, pika 1.3 dhe të nenit 161 pika 1 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit, Senati i këtij Universiteti në takimin e mbajtur më 03.12.2015, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ZGJEDHJEN E PERSONELIT AKADEMIK NË UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA" NË GJILAN

I. Dispozitat e Përgjithshme

Neni 1

Kjo Rregullore i përcakton kushtet e Përgjithshme për zgjedhjen e personelit akademik në marrëdhënie të rregullt pune të bazuara në Ligjin për arsimin e lartë dhe Statutin e Universitetit si dhe kriteret e veçanta për zgjedhjen e personelit akademik të nxjerra nga Senati i Universitetit.

Neni 2

Profesorët e rregullt, profesorët e asocuar dhe profesorët asistent duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të sukseshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike.

Neni 3

Universiteti siguron dhe mbështet barazinë gjinore. Në rastet kur kandidatët e gjinisë mashkullore dhe femërore i kanë kualifikimet e njëjta, përparësi do t'i jepet kandidatës femër.

Neni 4

Vendimin për shpallje të konkursit për zgjedhje apo rizgjedhje të personelit akademik e merr senati i universitetit sipas propozimit të njëjësive akademike.

Konkursi zgjatë 15 ditë kalendarike nga dita e shpalljes.

Vendimi për shpallje të konkursit për rizgjedhje duhet të miratohet nga senati 6 muaj para kalimit të kohës për të cilën janë zgjedhur.

Konkursi duhet të përmbajë lëmin shkencor në të cilin zgjidhet kandidati, afatin dhe kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për zgjedhje.

Neni 5

Kandidatët që i kanë kryer studimet bachelor, master, magjistraturë dhe doktoraturë - jashtë vendit, duhet të sjellin dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse, në të kundërtën, dosja e aplikantit do të konsiderohet e pakompletuar.

Neni 6

Për vlerësimin e kandidatëve formohet komisioni recensues. Komisionin recensues e formon Fakulteti apo Senati jo më vonë se 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit. Dekani në afat prej 8 ditëve i lajmeron formalisht anëtarët e komisionit recensues për formimin dhe përbëjen e tij.

Komisioni recensues përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë. Anëtarët e komisionit recensues mund të jenë intern ose ekstern (nga universitete tjera në vend dhe jashtë vendit).

Anëtarët e komisionit recensues nuk mund të jenë me thirrje më të ulët se thirrja për të cilën konkurron dhe zgjidhet kandidati.

Anëtarë të komisionit recensues mund të jenë edhe personat e pensionuar me thirrje shkencore (professor i rregullt dhe i asocuar), por jo edhe ata të cilët e kanë kaluar moshën 70 vjeçare.

Neni 7

Komisioni recensues shkruan Referatin Vlerësues me propozimin konkret për zgjedhje/mos-zgjedhje. Komisioni mbush Formularin e Vecantë me pikët për çdo kategori vec e vec, dhe pikët në total. Referatin Vlerësues dhe Formularin e vecantë i dorëzon njësisë akademike, për të gjithë kandidatët e paraqitur.

Komisioni recensues mund të vendosë për intervistim të kandidatëve dhe veçanërisht kur dy ose më tepër kandidatë kanë të arritura të ngjashme.

Neni 8

Referati i komisionit recensues përmban:

- Të dhënat për kandidatin;
- Të dhënat tjera për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe vlerësimin në bazë të kriterëve të veçanta sipas kësaj rregullore.

Në fund të Referatit qëndron propozimi për zgjedhje të kandidatit më të mirë ose për mos zgjedhje të asnjë kandidati. Propozimi për zgjedhje i elaboron arsyet për këtë propozim si dhe konstatimet për secilin kandidat që nuk është propozuar.

Komisioni recensues dorëzon raportin e tij nësisë akademike, brenda 30 ditëve kalendarike pas pranimit tëdokumenteve.

Nëse ndonjë anëtar i Komisionit recensues ka një mendim të ndryshëm në lidhje me propozimin për promovimin e kandidatit, atëherë ai anëtar është i inkurajuar që të paraqesë një „raport të veçantë” për strukturat menaxhuese të Fakultetit apo të Universitetit. Kjo duhet të jetë një raport i plotë në përputhje me kërkesat e detajuara këtu. Në raste të tilla, dekani do të paraqesë të dy raportet nëKëshill të Fakultetit apo Senat të Universitetit.

Fakulteti apo Senati i Universitytit mban të drejtën të pranojë njërin, tërefuzojë të dy raportet, por nuk mund të miratojë të dy për të njëjtëpozitë.

Universiteti, nëpërmjet Zyrës së burimeve njerëzore e publikon Referatin Vlerësues e komisionit recensues.

Nëse Fakulteti e miraton propozimin e komisionit, raporti dërgohet në Komision të studimeve për verifikim dhe më pastaj komisioni i studimeve i propozon Senatit për vendimarrje. Nëse Fakulteti nuk e miraton raportin, procedura mbaron këtu, kurse konkursi mund të rishpallet për atë pozitë.

Buletini i universitetit ku publikohen të gjitha raportet që shqyrtohen në Senat botohet të paktën 15 ditë para mbledhjes së Senatit, respektivisht pas propozimit të komisionit të studimeve.

Neni 9

Gjatë procesit të vlerësimit kandidatët i nënshtrohen prezantimit provues – vlerësues.Në cilësinë e vlerësuesit përveç anëtarëve të komisionit vlerësues do të asistojë paku edhe një anëtarë nga stafi menaxhues i Fakultetit apo Universitetit.

Neni 10

I gjithë personeli akademik gjatë periudhës së udhëhequr nga organet e përkohshme pas perfundimit të procedurave të rregullta do të emërohet nga Rektor, sipas vendimit të Senatit i bazuar në propozimin e njesisë akademike.

Neni 11

1. Në stafin akademik të Universitetit do të punësohen apo angazhohen personat në:
 - Mësimdhënie akademike;
 - Kërkime shkencore;
 - Krijimtari artistike.
2. Peroneli akademik përbëhet nga:
 - Profesorët e rregullt (Prof.Dr.);
 - Profesorët e asocuar (Prof.Asoc.Dr.);
 - Profesor asistentë (Prof.Ass.Dr.)
 - Ligjërues;
 - Asistent (Ass.).
 - Lektorët dhe korepetitorët

KUSHTET PËR PRANIMIN E PROFESORIT TË RREGULLT, PROFESORIT TË ASOCUAR DHE TË PROFESORIT ASISTENT

NENI 12

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I RREGULLT (PROFESOR DOKTOR, PROF. DR. DHE PRANIMI NË PUNË)

1. Për titullin e profesorit të rregullt të njësisë akademike, kandidati duhet të ketë gradën e doktorit të shkencës dhe thirrjen e profesorit të asocuar;
2. Emërimet për titullin Profesor i Rregullt si dhe kohëzgjatja e punësimit bëhen për kohë të pacaktuar.
3. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor i asociuar”, aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor Doktor”, të paktën, 5 (pesë) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”.
4. Personeli akademik që aplikon për titullin akademik “Profesor Doktor”, duhet të:
 - a) ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
 - b) jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 8 (tetë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;
 - c) ketë udhëhequr, të paktën, 2 (dy) doktorata, të përfunduara. Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë të përfunduar; të udhëhequr të paktën një doktorant+ edhe 5 (pesë) kandidate për master.
5. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor Doktor”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:
 - a) Ka botuar, së paku, 7 (shtatë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 5 (pesë) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 4 (katër) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
 - b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 5 (pesë) referime, nga të cilat, së paku 3 (tri) janë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
 - c) Ka realizuar së paku 2 (dy) monografi shkencore ose 2 (dy) libra universitarë.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4 (së mësipërme), të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

- a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor i asociuar” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njëسيا bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSERanking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore;
- b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 1 (një) artikull shkencor, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
- c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 4 (katër) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik “Profesor i asociuar”, në:

- a) komitete shkencore apo redaktuese;
- b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
- ç) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- d) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- dh) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
- e) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- ë) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

8. Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 7,8,9 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues, i cili rishikohet në Komisionin e Studimeve.

9. Për titullin “Profesor Doktor” kandidati duhet të tubojë më së pakut 91 pikë, sipas kësaj Rregulloreje.

NENI 13

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR I ASOCUAR (PROF. ASOC.) DHE PRANIMI NË PUNË

1. Për titullin e profesorit të asociuar kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë thirrjen e doktorit të shkencës dhe thirrjen akademike profesor asistent;

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

3. Personeli akademik, i cili ka titullin akademik “Profesor asistent”, aplikon për fitimin e titullit akademik “Profesor i asocuar”, të paktën, 4 (katër) vite pas fitimit të titullit akademik “Profesor asistent”.

4. Personeli akademik që aplikon për titullin akademik “Profesor i asocuar”, duhet të:

- a) ketë qenë titullar lënde ose moduli dhe udhëheqës i veprimtarisë shkencore për një periudhë jo më të shkurtër se 5 (pesë) vite akademike;
- b) jetë ose të ketë qenë i punësuar si personel akademik me kohë të plotë për një periudhë 5 (pesë)-vjeçare akademike, pas fitimit të gradës shkencore “Doktor”;;
- c) ketë udhëhequr, të paktën, 1 (një) doktoratë, të përfunduar (anëtar i komisionit për mbrojtjen e doktoratës). Në rast se kandidati ka ushtruar veprimtarinë e tij akademike shkencore pranë një njësie kryesore me më pak se 40 (dyzet) veta personel akademik me kohë të plotë, në momentin e aplikimit të ketë udhëhequr, së pakut 3 (tre) kandidate per master.

5. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin “Profesor i asocuar”, duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

- a) Ka botuar, së pakut, 5 (pesë) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së pakut, 3 (tre) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën, 3 (tre) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
- b) Ka realizuar si autor i parë, së pakut, 3 (tri) referime, nga të cilat, së pakut 1 (një) është mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “*Proceedings*”, të indeksuar me kod ISBN ose ISSN.
- c) Ka publikuar së pakut 1 (një) monografi shkencore ose 1 (një) libër universitar.

6. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4 (së mësipërme), të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

- a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, e botuar pas fitimit të gradës shkencore “Profesor asistent” brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësi bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografisë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore;
- b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 3 (tre) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
- c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:

- i. 5 (pesë) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
- ii. 3 (tre) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

7. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit akademik "Profesor i asociuar", në:

- a) komitete shkencore apo redaktuese;
- b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
- d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare
- g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 6, 7,8 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues, i cili rishikohet në Komisionin e Studimeve.

10.Për titullin "Profesor i asociuar" kandidati duhet të tubojë më së pakut 71 pikë, sipas kësaj Rregulloreje.

NENI 14

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR FITIMIN E TITULLIT AKADEMIK PROFESOR ASISTENT (PROF. ASS.) DHE PRANIMIN NË PUNË

1. Për ta fituar titullin Profesor asistent, kandidati duhet të:

- a) Të ketë gradën e doktorit të shkencës;
- b) ketë qenë titullar lënde ose moduli, ligjërues për një periudhë jo më të shkurtër se 3 (tri) vite akademike;
- c) apo asistent i rregullat për një periudhë jo më të shkurtër se 4 (katër) vjet.

2. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit është për 4 vite.

3. Personeli akademik, i cili aplikon për titullin "Profesor asistent", duhet të shfaqë zotërim të plotë të fushës së tij kërkimore, e cila reflektohet në realizmin e detyrimeve, si më poshtë vijon:

- a) Ka botuar, së paku, 3 (tre) artikuj shkencorë, të botuar në revista shkencore brenda vendit ose ndërkombëtare të indeksuara. Së paku, 1 (një) prej artikujve të jenë botuar në revista shkencore ndërkombëtare me faktor impakti, të rankuara në platformat digjitale të përcaktuara nga Udhëzimi Administrativ i MASHT. Kur këta artikuj janë në bashkautorësi, kandidati duhet të jetë autor i parë ose i dytë. Kandidati duhet të jetë autor i parë në, të paktën 1 (një) artikuj shkencorë të paraqitur për fitimin e titullit;
- b) Ka realizuar si autor i parë, së paku, 2 (dy) referime.

4. Kur kandidati paraqet monografi, e cila përmbush kriteret e mëposhtme, ai përjashtohet nga detyrimet e përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4 (së mësipërme), të këtij kreu, sipas ekuivalentimit që vijon:

- a) Botimi i 1 (një) monografie shkencore, por jo teza e doktoratës, brenda ose jashtë vendit, e cila duhet të përmbushë kushtet e origjinalitetit dhe duhet të jetë vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) vlerësues të pavarur të fushës kërkimore-shkencore, dhe të jetë pranuar nga njësia bazë, që mbulon fushën e kërkimit. Monografia shkencore e botuar jashtë vendit konsiderohet e vlefshme nëse shtëpia botuese është e rankuar nga *SENSE Ranking of Academic Publishers*, në kategorinë A, B, C ose D. Monografitë konsiderohen të ndryshme ndërmjet tyre kur ndryshojnë në përmbajtje me, të paktën, 70%. Monografia e botuar brenda vendit duhet të jetë e vlerësuar në përmbajtje si punim shkencor nga, të paktën, 2 (dy) “Profesorë Doktorë” të fushës kërkimore-shkencore;
- b) Monografia e botuar brenda vendit ekuivalentohet me:
 - i. 3 (tre) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 2 (dy) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.
- c) Monografia e botuar jashtë vendit ekuivalentohet me:
 - i. 5 (pesë) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore brenda vendit;
 - ii. 3 (tre) artikuj shkencorë, të botuar në revistë shkencore ndërkombëtare me faktor impakti.

5. Për efekt të promovimit akademik, institucionet e arsimit të lartë marrin në konsideratë angazhimin dhe pjesëmarrjen e kandidatit, pas fitimit të titullit Doktor Shkence, në:

- a) komitete shkencore apo redaktuese;
- b) veprimtari vlerësuese si anëtar komiteti shkencor apo redaktues, për llogari të periodikëve ose joperiodikëve shkencorë;
- c) projekte kërkimore-shkencore në nivel drejtuesi, koordinatori ose anëtari;
- d) përfitimin e financimeve me bazë konkurrimi në nivel kombëtar e ndërkombëtar;
- e) projekte të financuara nga programe me donatorë të huaj, të cilat sjellin përfitime për institucionin, në rolin e koordinatorit të projektit;
- f) vlerësimet e projekteve kërkimore kombëtare ose ndërkombëtare;
- g) si drejtues në komitetet organizuese të konferencave shkencore kombëtare ose ndërkombëtare;
- h) projektet e transferimit teknologjik të patentave.

Raporti për angazhimin dhe pjesëmarrjen për veprimtaritë e parashikuara në nenin 5,6,7 hartohet në mënyrë të detajuar nga Komisioni vlerësues, i cili rishikohet në Komisionin e Studimeve.

6. Për fitimin e titullit akademik “Profesor asistent”, botimet shkencore (në revista dhe konferenca) të vlefshme janë ato të realizuara pas mbrojtjes së titullit Doktor Shkence deri në datën e dorëzimit të dosjes së aplikimit për titullin akademik “Profesor asistent”.

7. Për titullin “Profesor asistent” kandidati duhet të tubojë më së pakut 51 pikë, sipas kësaj Rregulloreje.

KRITERET E VEÇANTA PËR FITIMIN E TITUJVE AKADEMIKË

Neni 15

15.1. Logaritja e pikëve për kandidatët bëhet në këtë ndarje:

<i>Shkollimi+fusha e veprimtarisë</i>	<i>Pikët</i>
1. Bachelor	3 deri 10 pikë
2. Master	3 deri 10 pikë
3. PhD	3 deri 10 pikë
4. Prezentimi provues	0 deri 10 pikë
5. Gjuhët e huaja	0 deri 10 pikë
6. Punimet	0 deri 40 pikë
7. Veprimtari të tjera shkencore dhe angazhime akademike	0 deri 10 pikë

15.2. Pikët e logaritura nga nota mesatare e studimeve:

<i>Notat</i>	<i>Bachelor</i>	<i>Master</i>	<i>PhD</i>
Nota 6 deri ne 7	1	1	1
Nota 7 deri ne 7.50	2	2	2
Nota 7.5 deri ne 8	3	3	3
Nota 8 deri ne 8.5	5	5	5
Nota 8.5 deri ne 9	7	7	7
Nota 9 deri ne 9.5	9	9	9
Nota 9.5 deri ne 10	10	10	10

- a) Në rast se kandidati i ka të kryer studimet themelore 4 vjeçare dhe ka vazhduar në studimet e doktoratës, atëherë vlerësimi i poenave të masterit llogaritet me sa vijon:
- Nëse ekziston nota mesatare në PhD, mbliidhet me notën mesatare të studimeve themelore dhe pjestohet për 2.
 - Nëse nuk ka notë mesatare në PhD, atëherë zbatohet nota mesatare e studimeve themelore.
 - Në raste kur nuk specifikohet nota mesatare në PHd, komisioni recensues bënë vlerësimin dhe cakton poentimin në bazë të fushës së studimeve si dhe pozitës për të cilën konkurron kandidati apo kandidatja.

15.3. Pikët nga prezentimi provues

Prezentimi provues	0 deri në 10 pikë
--------------------	-------------------

- a) Vlerësimi i prezentimit provues bëhet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqësues i Fakultetit apo Universitetit. Kandidati informohet më herët për prezantimin dhe ai është i lirë të zgjedhë vetë temën që do të prezantojë.

15.4. Pikët nga njohja e gjuhëve të huaja

		Pikët (Totali) 10 pikë
--	--	------------------------

Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze (ose një gjuhë tjetër botërore)	0-4
	Gjuhë rajonale (sllave,turke, greke etj.)	0-3
	Gjuhë të tjera	0-3

- a) Nëse komisioni nuk ka njohuri të mjaftueshme për vlersim, atëhere kërkohen dokumente shtesë kredibile që dëshmojnë njohuritë nga gjuhët e huaja apo caktohet personi kompetent për vlerësim.

15.4. Pikët minimale nga publikimet shkencore

<i>Lloji i publikimit</i>	Totali: 40 pikë
Punim në revista ndërkombëtare, të rankuara sipas Vendimit të MASHT	0-7
Punim në revista rajonale (Shqipëria, Maqedonia, Mali i zi, Serbia)	0-3
Punim në revista Kosovare	0-2
Libra universitarë (? Defino botuesin)	0- 5
Monografi shkencore	0-10
Libra të tjerë	0-3
Referime shkencore ndërkombëtare (simpoziume, konferenca, kongrese), të publikuara në Proceedings	3
Referime shkencore vendore (simpoziume, konferenca, kongrese), të publikuara në Proceedings	2

Pikët në këtë tabelë janë të logaritura për një punim. Në rast se kandidati ka më tepër punime, shumëzohet me numrin për një punim dhe llogariten të gjitha.

15.5. Përvoja e kandidatit në aktivitete të tjera shkencore

<i>Aktivitete dhe përvoja</i>	<i>Pikët e përgjithshme për një aktivitet: 10 pikë</i>
kryesues apo anëtar i këshillit shkencor të një konference shkencore organizuar nga UKZ	0- 6 (?)
kryesues apo anëtar i Këshillit Shkencor (e të ngjashme) të një konference shkencore vendore a ndërkombëtare; kryeredaktor apo anëtar i redaksisë së një reviste shkencore vendore a ndërkombëtare	0-5
koordinator në një projekt të Erasmus+ ose Horizon 2020	10
menaxher i një projekti të Erasmus+ ose Horizon 2020	5

drejtor i institutit hulumtues	5
hulumtues i institutit hulumtues	2
Përfitues i një projekti hulumtues e financiar, i cili sjell përfitime financiare për institucionin mbi 10.000 Euro	5

FITIMI I TITULLIT ASISTENT DHE PRANIMI NË PUNË

Neni 16

Kushtet e përgjithshme – Asistent

1. Per titullin e asistentit kandidati duhet t`i plotësojë këto kushte:
 - Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master në drejtimin përkatës;
 - Të jetë jo më i vjetër se 30 vjet kur emërohet për herë të parë; për Fakultetin e Mjekësisë të jetë 35 vjet.
 - Të jetë i regjistruar në studimet e doktoratës në Universitet me rastin e rizgjedhjes;
2. Të ketë notën mesatare në studimet bachelor dhe master jo më pak se 8., (në secilin vec e vec)
3. Të gjitha emërimet si dhe kohëzgjatja e punësimit zgjat 3 vite.
4. Asistentët mbajnë orët e ushtrimeve në studimet bachelor dhe master.
5. Përjashtimisht asistenti që është rizgjedhur, në mungesë të profesorit për lëndën mund të autorizohet për mbajtjen e ligjëratave të kufizuara në studimet bachelor me autorizimin e këshillit të njësisë akademike dhe nën mbikëqyrjen e një mësimdhënësi nga departamenti - katedra.

Neni 17

17.1. Kriteret e veçanta- Asistent

<i>Niveli i studimeve</i>	<i>Pikët</i>
Bachelor	15 deri 30 pikë
Master	15 deri 30 pikë
Prezantimi vlerësues	0 deri 30 pikë
Gjuhët e huaja	0 deri 10 pikë

17.2. Pikët e logaritura sipas notave në nivelet e studimeve

<i>Notat</i>	<i>Bachelor</i>	<i>Master</i>	<i>Pikët (Totali)</i>
Nota 8 deri ne 8.5	15	15	15
Nota 8.5 deri ne 9	20	20	20
Nota 9 deri ne 9.5	25	25	25
Nota 9.5 deri ne 10	30	30	30

17.3. Prezantimi provues

Prezantimi provues	0 deri në 30 pikë
--------------------	-------------------

- a) Vlerësimi i prezentimit provues bëhet nga anëtarët e komisionit recensues dhe së paku nga një përfaqësues i Fakultetit apo Universitetit.

17.4. Njohja e gjuhëve të huaja

		Pikët (Totali) 10 pikë
Gjuhë e huaj	Gjuhë angleze	0-4
	Gjuhë rajonale (sllave,turke, greke etj.)	0-3
	Gjuhë të tjera	0-3

Neni 19

1. Për titullin e lektorit të gjuhëve të huaja, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduar me sukses studimet master në gjuhën e zgjedhur;
- Të ketë aftësi të shkëlqyeshme të gjuhës së zgjedhur;
- Të ketë notën mesatare të studimeve bachelor dhe master jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve.

2. Lektorët në fakultetet e tjera pos në fakultetin amë i kanë të gjitha të drejtat dhe obligimet për mbajtjen e ligjëratave.

3. Për titullin e Korepetitorit, kandidati duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë të përfunduar me sukses studimet Master, drejtimi i pianos ose ndonjë instrumenti tjetër;
- Të ketë notë mesatare jo më pak se 8, në secilën prej këtyre studimeve;

1. Të gjitha emërimet për tituj si dhe kohëzgjatja e punësimit janë për 3 vite.